



Pranimi / Received Prilaps / Produced Recieved / Produced	04.02.22	2	veti post post
Organ / Organ Organ / Organ Org / Org	SKINSPEK	564/2022	117
Si Prot Si Prot Prot No		Shkencë Pilog Apparite	Salla Klasore Library



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1210/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1210/2021 të datës 22.12.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi: kundër Vendimit Nr.prot:73/2021 i datës 13.12.2021 të Inspektoratit të Punës, në çështjen juridike "*Kontestim Konkursi*" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 04.02.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET pjesërisht si e bazuar** ankesa me numër A.nr.1210/2021 e datës 22.12.2021 e parashtruar nga ankuesi
- II. **SHFUQIZOHET** Vendimin Nr.prot:73/2021 i Njësisë së Burimeve Njerëzore të Inspektoratit të Punës i datës 13.12.2021.
- III. **SHFUQIZOHET** Lista e aplikantëve të aprovuar me numër reference RN00007806 si dhe **anulohet** procedura rekrutimit me numër reference: RN00007806 për pozitën "*Udhëheqës i Divizionit për Koordinim Rajonal-Departamenti i Koordinimeve në Rajonin e Ferizajt*" e shpallur në konkursin e datës 08.11.2021.
- IV. **OBLIGOHET** Kryeinspektori i Inspektoratit të Punës që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit ligjor prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.



A r s y e t i m

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve-**Inspektorati i Punës** me datë 08.11.2021 ka publikuar njoftimin për konkursin me numër reference: RN0007806 për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Koordinim Rajonal-Departamenti i Koordinimeve në Rajonin e Ferizajt", në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi

Njësia e Burimeve Njerëzore me datë 07.12.2021 ka nxjerrë vendimin më numër:67/2021 përmes të cilit ankuesit i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin se i njëjti nuk e ka kompletuar aplikacionin sipas kërkesave të konkursit. Ndaj vendimit të datës 07.12.2021 ankuesi ka parashtruar ankesë në Njësinë e Burimeve Njerëzore me datë 10.12.2021, ndërsa Njësia e Burimeve Njerëzore me datë 13.12.2021 ka nxjerrë vendimin numër prot:73/2021 duke e refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar.

Ankuesi kundër Vendimit Nr.prot:73/2021 të datës 13.12.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është pranuar më datë 22.12.2021 dhe është protokolluar me numër: 6282/2021 me pretendimet ankimore se Njësia e Burimeve Njerëzore nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike ngase ankuesi ka bërë kërkesë në Njësinë e Burimeve Njerëzore me u shërbye me dokumentin që dëshmon se i njëjti nuk ka të shqiptuar masë disiplinore dhe po ashtu çështja e vlerësimit të rezultateve në punë është obligimi ligjor i mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë dhe në mungesë të ofrimit të formularëve të vlerësimit të rezultateve në punë e kam pas të pamundur dhe më është mohuar e drejta për ankimim sipas nenit 13 të rregullores Nr.21/2021 për Procedurat e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil, po ashtu kandidatja Kosovare është përfshirë në listën e kandidatëve aplikacioni i së cilës është pranuar dhe e njëjta ka masë të shqiptuar disiplinore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datën 30.12.2021 në Inspektoratin e Punës ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit, ndërsa me datë 13.01.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Inspektorati i Punës me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 22.12.2021 e parashtruar në këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit civil të Kosovës me numër prot:6282/2021; Ankesën e datës 10.12.2021; Vendimin e datës 13.12.2021 me numër reference Nr. prot 73/2021; Vendimin e datës 07.12.2021 me numër Nr.prot 67/2021; Vendimin e datës 06.06.2019 me numër prot:06/2019; Akt emërimin e datës 06.12.2019; Akt emërimi i datës 01.01.2015; Çertifikatën e datës 05.03.2015; Çertifikatën e datës 07.11.2014; Çertifikatën e datës Çertifikatën e datës 06.05.2021; Çertifikatën e datës 13.02.2019; Çertifikatën e datës 15.03.2019; Çertifikatën e datës 23.06.2016; Çertifikatën e datës 26.04.2021; Çertifikatën e datës 30.01.2019; Çertifikatën e datës 01.06.2021; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punës për ankuesin i datës 21.12.2016; Vërejtjen me shkrim të datës 06.02.2020; E-mailin e datës 02.05.2020 dërguar nga ankuesi për Kosovare Konkursin e datës 04.02.2021; Njoftimin e datës 05.03.2021; Njoftimin e datës 08.04.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 30.12.2021; Përgjigjen në kërkesë e datës 13.01.2022 me numër prot:128/2022; Vërtetimin e datës 30.11.2021; Lista e aplikantëve me numër reference:RN00007806; E-mailin e datës 25.05.2021; E-mailin e datës 13.01.2022 dërguar nga për me korrespondencën e bashkangjitur prej 5 (pesë) faqesh; Vendimin e datës 07.12.2021 me numër.Prot67/2021; Konkursin e datës 08.11.2021; Vendimin e datës 07.12.2021 me numër.prot:70/2021; Diplomën e datës 22.10.2008 me numër:663; Diploma Nr.657 e datës 20.03.2015; Vërtetimin e kopjes nga origjinali lëshuar nga noteri me numër:10963/2020; Diplomën e datës 25.09.2003 më numër:333; Vërtetimin e datës 27.08.2018; Ndryshimin dhe Plotësimin e Aktit të emërimit të datës 25.02.2016; Akt emërimi i datës 04.02.2012; Akt emërimi i datës 05.04.2012; vërtetimin e datës 12.06.2021; Kontratën e punës të datës 01.09.2004; Referencën e lëshuar nga Menaxheri i Prokurimit në

Qendrën e Kosovës për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim për kandidatit Referencën e datës
 15.04.2013; Kopjen e letërnjoftimit të kandidatit Formularin e vlerësimit në punë për kandidatit
 të datës 29.01.2021; Formularin e vlerësimit në punë për kandidatit të datës
 26.12.2019; Vërtetimin e datës 25.03.202; Çertifikatën e lëshuar me datë 13.07.2021 nga Gjykata Themelore
 në Mitrovicë-Dega Vushtrri; Çertifikatën e lëshuar nga FLSA; Çertifikatën e periudhës korrik 2019;
 Çertifikatën e avancuar profesionale për avancim me numër 246; Vërtetimin e Policisë së Kosovës të datës
 26.07.2021; Çertifikatën e avancuar profesionale për avancim me numër 349; Çertifikatën e datës 04.06.2010;
 Çertifikatën e datës 15.11.2005; Çertifikatën e 06.11.2007; Çertifikatën e kandidatit lëshuar nga
 ResourceHUB; Çertifikatën e kandidatit lëshuar nga BSC KOSOVO; Aplikacionin e kandidatit
 i datës 30.11.2021; Vendimi i datës 07.12.2021 me numër prot:65/2021; Aplikacionin e datës
 27.11.2021 të kandidatit me shkresën e bashkangjitur prej 2 (dy faqesh) të datës v28.02.2011;
 Letërnjoftimin e kandidatit Akt emërimit e datës 03.12.2018; Vendimin e datës 23.11.2011;
 Çertifikatën e datës 15.08.2009; Akt emërimit e datës 21.02.2014; Diplomën e datës 20.01.2011 lëshuar nga
 Universiteti Shtetëror i Tetovës; Vendimin e datës 07.12.2021 me numër:66/2021; Vendimi i datës 07.12.2021
 me numër:68/2021; Akt emërimit e datës 01.01.2015; Çertifikatën e datës 21.12.2009; letër referencën e datës
 12.09.2013; Referencën e datës 11.09.2013; Formularin e vlerësimit në punë për kandidatit i
 datës 10.01.2020; Formularin e vlerësimit në punë për kandidatit datës 08.01.2019; Vërtetimin
 e datës 30.11.2021; Diplomën e datës 28.03.2019 me numër:6161; Çertifikatën e datës 04.06.2021; Çertifikatën
 e datës 23.06.2015; Çertifikatën e lëshuar nga LGA dhe KLGJ; Çertifikatën e datës 19.03.2015; Çertifikatën e
 datës 07.11.2014; Çertifikatën e datës 05.03.2015; Akt emërimit e datës 07.11.2019; Diplomën e ankuesit të
 datës 08.05.2019 me numër:8093; Aplikacionin e ankueses të datës 30.11.2011; Diplomën e datës 22.02.2019
 Nr.276/19; Rekomandimin e lëshuar nga Avonet; Akt emërimit e datës 01.11.2017; Akt emërimit e datës
 01.01.2016; Kontratën konsulentë të lidhur me ASK e identifikuar me shifër Nr.23/02/RB/2014; Çertifikatën
 e lëshuar nga Avonet e periudhës shkurt 2013; Çertifikatën e lëshuar nga Avonet e periudhës qershor 2013;
 Diplomën e datës 19.07.2011 me numër:116/11; Kopjen e letërnjoftimit të kandidatit
 Vërtetimin e datës 30.11.2021; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë e datës 25.01.2021;
 Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë e datës 30.12.2019; Kopjen e letërnjoftimit të kandidatit
 Kosovare Vendimin e datës 07.12.2021 Nr.prot:69/2021; Aplikacionin e ankuesit të datës
 24.11.2021; Diplomën e datës 19.05.2010 me numër: 157/10; Akt emërimit e datës 01.01.2015; Vendimin e
 datës 06.06.2019; Çertifikatën e datës 06.05.2021; Çertifikatën e datës 26.04.2021; E-mailin e datës 02.02.2022
 dërguar nga zyrtari i Këshillit për

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës ka
 konstatuar që ankesa e ankuesit është pjesërisht e bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave gjatë vlerësimit të provave të lëndës të ofruara nga palët në
 procedurë, ka konstatuar se në bazë të konkursit me numër reference: RN0007806 për pozitën Udhëheqës i
 Divizionit për Koordinim Rajonal-Departamenti i Koordinimeve në Rajonin e Ferizaj i shpallur nga
 Inspektorati i Punës me datë 08.11.2021 kriteret e këtij konkursi kanë qenë: *“Diplomë/a Universitare me të
 paktën 240kredi/ECTS apo ekuivalente me to, nga fushat Juridike, Ekonomike dhe Teknike”,* ndërsa si
 dokumente që duhet të paraqiten për aplikim kanë qenë: *“Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet
 arsimore, kopjet e dëshmisë së punësimit, kopjet e dëshmisë së trajnimeve, kopjen e vlerësimit të vlerësimeve
 të punës për dy vitet e fundit dhe dokumentet që dëshmon se nuk kemi ndonjë masë disiplinore që nuk është
 shuar ende”.*

Po ashtu, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka gjetur se Njësia e Burimeve Njerëzore e
 Inspektoratit të Punës me datë datë 07.12.2021 ka nxjerrë vendimin më numër:67/2021 përmes të cilit ankuesit
 i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin se i njëjti nuk e ka kompletuar aplikacionin sipas kërkesave të

konkursit, ndërsa në bazë të shkresa të lëndës të ofruara nga palët në procedurë është konstatuar se ankuesi me rastin e aplikimit në konkursin e lartcekur nuk ka bashkangjitur edhe dëshmitë për vlerësimet e rezultateve në punë për dy vitet e fundit dhe po ashtu nuk ka bashkangjitur as dëshminë se i njëjti nuk ka masë të shqiptuar aktualisht, andaj ndërlidhur me atë që u theksua si më lartë Njësia e Burimeve Njerëzore me rastin e analizimit dhe shqyrtimit aplikacionit të ankuesit kur edhe e ka refuzuar me vendimin e datës 07.12.2021 në mungesë të plotësisimit sipas kërkesave të përcaktuara në konkurs ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës neni 15 paragrafët 1, 2 dhe 5 ku përcaktohet se: *"Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërlidhen me verifikimin paraprak, 5. Kandidatë, që nuk plotësojnë kushtet për aplikim në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin. Vendimi për mosplotësimin e kushteve për aplikim, arsyetohet dhe u njoftohet individualisht aplikantëve, jo më vonë se katërmëdhjetë (14) ditë kalendarike nga data përfundimtare e pranimit të aplikacioneve"* ndërlidhur me nenin 12 paragrafin 2 nën paragrafin 2.3 ku përcaktohet: *"kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e konkurrimit dhe të deklaruara në aplikacion"*, pasi që ankuesi në momentin e aplikimit nuk ka bashkangjitur edhe formularët e vlerësimit të rezultateve në punë dhe dëshminë se i njëjti nuk ka në fuqi ndonjë masë të shqiptuar disiplinore.

Ndërsa, sa i përket pretendimeve ankimore të ankuesit se ka bërë kërkesë në Njësinë e Burimeve Njerëzore me u shërbye me dokumentin që dëshmon se i njëjti nuk ka të shqiptuar masë disiplinore dhe po ashtu çështja e vlerësimit të rezultateve në punë është obligimi ligjor i mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë dhe në mungesë të ofimit të formularëve të vlerësimit të rezultateve në punë e kam pas të pamundur dhe më është mohuar e drejta për ankim sipas nenit 13 të rregullores Nr.21/2021 për Procedurat e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil, Kolegji ka konstatuar se ankuesi nuk ka arritur të dëshmojë me asnjë provë se për dy të drejtat që i janë cenuar nga institucioni punëdhënës të ketë parashtruar fillimisht kërkesë që të vlerësohet apo të shërbehët me dëshminë se nuk ka të shqiptuar masë disiplinore apo të vlerësohet për rezultatin për dy vitet e fundit të punës, ndërsa më pas të ketë parashtruar ankesë brenda institucionit apo në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës siç e kanë rregulluar Ligjit nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik neni 24 paragrafi 2 dhe 3 ku përcaktohet: *"Zyrtari publik ka të drejtë të qasjes në dosjen e tij personale dhe të kërkojë ndryshimin dhe plotësimin e të dhënave të saj. 3. Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji. E drejta e ankimit në KPMSHC i njihet edhe çdo kandidati në një procedurë pranimi në Shërbimin Civil. Pas shterimit të drejtës së ankimit në KPMSHC, mund të iniciohet konflikt administrativ në gjykatën kompetente për çështjet administrative"* dhe Ligji Nr.03/L149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës neni 50 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet: *"Nëpunësit civilë kanë të drejtë për ankesë kundër vendimit administrativ apo çdo shkelje ose lëshim të rregullave ose procedurave të përgjithshme administrative, që ndikojnë dhe që kanë të bëjnë me marrëdhënien e tyre të punës. 2. Nëpunësit civilë kanë të drejtë mbrojtjeje përmes procedurave të brendshme administrative ose gjyqësore në rast të një shkeljes së të drejtave të tyre, që rezulton nga një veprim i administratës publike"* dhe neni 81 paragrafi 1 dhe 2 me nën paragrafët 2.1 dhe 2.2 i të njëjtit ligj ku përcaktohet: *"Organe të veçanta për zgjidhjen e kontesteve të punësimit dhe të ankesave në shërbimin civil do të themelohen në kuadër të secilit institucion të administratës qendrore dhe komunale, që ka nëpunës civilë. 2. Procedurat për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave zhvillohen nga këto organe: 2.1. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; dhe 2.2. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës"* dhe mbi këtë bazë pretendimi ankimor i ankuesit është i pabazuar dhe se i njëjti nuk ka arritur të arsyetoj me prova se ka bërë ndonjëherë kërkesë siç pretendon.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave gjatë analizimit të shkresave të lëndës të ofruara nga institucioni punëdhënës, respektivisht Listës së aplikantëve të gjencruar nga SIMBNJ-Sistemi për menaxhimin

e burimeve njerëzore, ka gjetur se kandidatja është përfshirë në listën e kandidatëve aplikacioni i së cilës është pranuar edhe sipas Vendimit Nr.prot:69/2021 të datës 07.12.2021, e njëjta sipas vërtetimit të datës 30.11.2021 të lëshuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Inspektoratit të Punës rezultoi që nuk ka të shqiptuar asnjë masë disiplinore, mirëpo ankuesi në ankesën e tij ka ofruar dëshmi se në kohën sa i njëjti kishte qenë Ushtrues Detyre i Udhëheqësit të Koordinimeve në Rajonin e Ferizajt sipas vendimit të datës 06.06.2019, i ka shqiptuar kandidates së lartcekur vërejtje me shkrim e cila është protokolluar me datë 06.02.2020 dhe mbanë numër protokolli:05/2020 për të cilën vërejtje është vënë në dijeni përmes e-mailit të datës 05.02.2020 ankuesja dhe po ashtu edhe ushtruesi i Detyrës së Kryeinspektorit të Inspektoratit të Punës dhe njëherit Drejtor i Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme në kuadër të cilit Departament asaj kohe ka qenë edhe Njësia e Burimeve Njerëzore, andaj me rastin e refuzimit të ankesë së ankuesit të datës 10.12.2021 kundër vendimit më numër:67/2021 të datës 07.12.2021 Njësia e Burimeve Njerëzore ka vepruar në kundërshtim me nenin 134 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“Krahas kërkesave të nenit 48 të këtij Ligji, arsytimi i aktit administrativ që zgjidh ankesën, do të përmbajë, gjithashtu, vlerësimet e të gjitha pretendimeve të parashtruara nga pala në ankesë”* ngase ankuesi e kishte pretendim se kandidatja e përfshirë në listën e kandidatëve të cilëve iu ishte aprovuar aplikimi dhe se Njësia e Burimeve Njerëzore i ka pasur të gjitha kompetencat dhe mundësit ligjore të sigurojë informatën e nevojshme nëse e njëjta ka pasur të shqiptuar masë disiplinore dhe po ashtu në kuptim të neni 10 paragrafi 4 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se: *“Të gjitha dokumentet e dorëzuara siç kërkohen nga shpallja e konkurrimit, kandidati, përmes aplikacionit, vet deklaroi se janë të vërteta dhe mban përgjegjësi për vërtetësinë e tyre. Deklarimi i rrejshëm paraqet shkak për përjashtimin nga procedura e pranimin”* Njësia e Burimeve njerëzore ka pasur mundësinë të ftojë në konsultë kandidaten, andaj mbi këtë bazë dhe në kuptim të nenit 83 pika 14 të Ligjit nr.06/L-114 për Zyrarët Publik ku përcaktohet se: *“Masat disiplinore, të marra para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë edhe sipas këtij ligji. Zbatimi dhe fshirja e masës do të bëhet sipas këtij ligji”* ndërlidhur me nenin 51 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 i të njëjti ligj ku përcaktohet se: *“Masat disiplinore të shënuara në dosjen e personelit shuhen, pas kalimit të katër afateve: 1.1. dy (2) vjet nga njoftimi i masës së parashikuar në paragrafët 1.1 dhe 1.2 të nenit 47 të këtij ligji”*, nga njëra se ende s’ka kaluar koha për shuarjen e masës, dhe me këtë rast Njësia e Burimeve Njerëzore Vendimin Nr.prot:73/2021 i datës 13.12.2021 e ka nxjerrë në kundërshtim me nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet: *“Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.5. është në kundërshtim me ligjin material; 1.6. është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme”* dhe si i tillë vendimi në fjalë është i kundërligjshëm dhe duhet shfuqizuar, ndërsa pretendimi ankimor i ankuesit në ankesë e tij të parashtruar në Këshill së njëra nga kandidatët aplikacioni i së cilës është aprovuar ka të shqiptuar masë disiplinore është i bazuar.

Po ashtu, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave gjatë analizimit të shkresave të lëndës të ofruara nga institucioni punëdhënës, respektivisht Listës së aplikantëve të gjeneruar nga SIMBNJ-Sistemi për menaxhimin e burimeve njerëzore, ka gjetur se kandidatit është përfshirë në listën e kandidatëve aplikacioni i së cilës është pranuar edhe sipas Vendimit Nr.prot:70/2021 të datës 07.12.2021, ndërsa i njëjti sipas vërtetimit të datës 25.03.2021 të lëshuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike rezultoi që kandidati nuk ka të shqiptuar asnjë masë disiplinore, mirëpo Njësia e Burimeve Njerëzore e Inspektoratit të Punës me rastin e shqyrtimit të aplikacionit të kandidatit nuk ka përmbushur në plotni funksionin e saj siç parashihet me nenin 15 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se: *“Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim. 2.Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërlidhen me verifikimin paraprak”*, pasi që vërtetimi i lartë cekur nuk mbulon edhe periudhën kohore prej datës 26.03.2021 deri në momentin e aplikimit apo të paktën deri në momentin e shpalljes së konkursit me datë 08.11.2021 nëse

eventualisht kandidati mund të ketë masë të shqiptuar apo jo disiplinore pa predikuar fajësinë e tij, ndërsa këshilli me datë 02.02.2022 me e-mail i është drejtuar Njësisë së Burimeve Njerëzore të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike më kërkesën nëse kandidati i lartë cekur në konkursin respektiv i cili rezultoi të jetë nëpunës i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike ka apo jo të shqiptuar ndonjë masë disiplinore në intervalin kohor prej datës 26.03.2021 deri në momentin e kërkesës së datës 02.02.2022, ndërsa Njësia e Burimeve Njerëzore e Akademisë së Kosovës për Siguri Publike përmes e-mailit me datë 03.02.2022 ka dhënë përgjigje në kërkesën e Këshillit me njoftimin se ndaj të lartcekurit nuk ka asnjë masë të shqiptuar disiplinore as pas datës 25.03.2021 dhe as nuk është duke u zhvilluar procedurë disiplinore ndaj tij, andaj me këtë rast Njësia e Burimeve Njerëzore e Inspektoratit të Punës nuk e ka kryer obligimin e saj sipas dispozitave ligjore që e obligojnë t'i shqyrtojnë aplikacionit dhe t'i verifikojnë provat sipas detyrës zyrtare me qëllim të eliminimit të çdo dileme eventuale, pasi që në raste tjera për lëshime të tilla eventualisht mund të përfshihen persona me masa aktive disiplinore në listën e të pranuarve.

Kolegji për shqyrtimin e kontesteve dhe të ankesave, thekson faktin se aplikacioni i ankuesit është refuzuar me të drejtë nga Njësia e Burimeve Njerëzore ngase i njëjti nuk ka arritur të bashkëngjis dëshmi mbi vlerësimin e rezultateve të punës për dy vitet e fundit dhe dëshminë së i njëjti nuk ka masë disiplinore aktive me rastin e aplikimit në konkursin e datës 08.11.2021 andaj mbi këtë bazë këto dy pretendime ankimor të ankuesit janë refuzuar, ndërsa pretendimi ankimor i ankuesit se njëri nga kandidatet aplikacioni i së cilës është aprovuar ka pasur masë të shqiptuar disiplinore është i bazuar andaj mbi këtë bazë dhe të gjeturave tjera të evidentuar në arsyetimin si më sipër të këtij vendimi, Kolegji ka konstatuar dhe vendosur se procedura e rekrutimit për konkursin e datës 08.11.2021 për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Koordinim Rajonal-Departamenti i Koordinimeve në Rajonin e Ferizajt" është zhvilluar në kundërshtim me nenin 6 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit nr.06/L-114 për Zyrarët Publik ku përcakton se: *"Pranimi në detyrë i nëpunësit civil, nëpunësit të Shërbimit Publik dhe nëpunësit administrativo-teknik dhe mbështetës, bazohet në parimet e mundësive të barabarta, meritës dhe integritetit, mos-diskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe proporcional gjinor dhe të komuniteteve. 2. Pranimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës profesional, transparent e të drejtë, që garanton mundësi të barabarta për kushte të barabarta dhe përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar për kryerjen e detyrave përkatëse, duke garantuar përfaqësim minimal të komuniteteve dhe të gjinive"* mbi këtë bazë konkursi i datës 08.11.2021 me numër reference RN0007806 për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Koordinim Rajonal-Departamenti i Koordinimeve në Rajonin e Ferizajt" është anuluar i shpallur nga Inspektorati i Punës është anuluar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke u bazuar në të gjeturat e kësaj lënda sipas shkresave dhe pretendimeve të palëve në procedurë, thekson se Kryeinspektori i Inspektoratit të Punës si zyrtari më i lartë administrativ i institucionit duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme administrative në bazë të kompetencave që ka, dhe se duhet kujdeset që të gjithë të punësuarve në institucionin që drejton tu bëhet vlerësimi i rezultateve në punë dhe të shqyrtojë kërkesat e tjera që burojnë nga marrëdhënia e tyre e punës, në pajtim me dispozitat e Ligjit nr.06/L-114 për Zyrarët Publik dhe Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë për Nëpunësit Civil dhe Nëpunësit e Shërbimit Publik, ngase si pasojë e mos kryerjes së obligimeve sipas detyrës zyrtare (ex-officio) nga ana e institucionit punëdhënës me rastin e mos-vlerësimit, ankuesit i është mohuar e drejta për t'iu nënshtruar procedurave për ngritje në detyrë e garantuar me dispozitat e aplikuara të ligjeve në fuqi.

Me dispozitat e nenit 21 paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar se: *"Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës"*, dhe me dispozitat e nenit 24 paragrafit 1 të po këtij ligji është përcaktuar se: *"Në rast të*

moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit".

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.1210/2021

Flakron GASHI



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Kryeinspektorit të Inspektoratit të Punës;
- Udhëheqësit të Personelit në Inspektoratin e Punës dhe Arkivit të KPMSHCK- së.

